



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Lirije Maksutaj dhe sekretaren juridike, Kaltrina Citaku në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, Vehbi Ahmeti Rr."Gazmend Zajmi" Hyr.A/Kati i III nr.5 Gjilan kundër të paditurës, Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale (MPMS/DAP-së) të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore-Ministra e Drejtësisë, baza e kontestit anulimi i aktvendimit kontestues, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me dt.14.02.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M



Refuzohet si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit Vehbi Ahmeti me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës, MPMS/DAP-së, dt.17.06.2014 dhe ti njihet e drejta për shoqëruesin për persona të verbër si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Seanca e shqyrtimi kryesor është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA –së, në prezencën e paditësit dhe mungesë të të paditurës pasi gjykata ka konstatuar se ka dëshmi se është ftuar me rregull.

Paditësi lartcekur në padinë e drejtuar kësaj gjykate me padi me dt.29.07.2014, ka kundërshtuar aktvendimet e organeve administrative ne shkallë të parë dhe të dytë si të pabazuara pasi pretendon se i njëjti i plotëson kriteret për kompozim material të grupit te parë pasi këta persona nuk i dallojnë dritën nga errësira prandaj nga kjo gjykatë ka kërkuar që pas administrimit të provave të bie aktgjykim me të cilin e aprovon padinë dhe te vendos sipas ligjit.

E autorizuar e të paditurës në përgjigjen e dhënë me shkrim në padi kësaj gjykate me dt.27.12.2016 ka theksuar se aktvendimi i te paditurës është nxjerr plotësisht ne përputhje me ligjin ne fuqi prandaj nga nga gjykata ka kërkuar që pas administrimit të provave të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e kontestuar me padi të lenë në fuqi si vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.14.02.2017, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i Ministrisë dt.17.06.2014, udhëzimi për konsultim dt.02.07.2014, dt.03.07.2014, dt.04.07.2014, dt.28.05.2014, kontrata për caktimin e shoqëruesit për personin e verbër, vendimi dt.15.01.2014 i paditurës, përgjigje ne padi dt.27.12.2016, vendim dt.13.10.2016, dt.18.05.2016, ankesa e paditësit dt.03.06.2016, udhëzim nga konsulta dt.02.02.2016, vlerësimi i komisionit Mediko-social dt.22.10.2013, dt.10.03.2016, dt.16.04.2016, raporte dt.25.03.2013, dt.12.02.2013, dt.15.02.2013, dt.12.07.13, dt.16.09.15, formulari për aplikim dt.22.08.2013 e shkresa tjera.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, dhe pas vlerësimit të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjes të paditurës në padi dhe pas shqyrtimit të të gjithave shkresave tjera të lëndës, konstatoi se padia e paditësit është e pa bazuar.

Me vendimin e goditur me padi është refuzuar ankesa e ankuesit për njohjen e të drejtës në kompensim material të personave të verbër të grupit të dytë, me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret nga ligji nga se kësaj kategorie i takojnë personat të cilët nuk e dallojnë dritën nga errësira deri në qartësinë e të parit 0.02 si e parasheh paragrafi 6 i nenit 17 i Ligjit, 04/L-092 për persona të verbër .

Kjo gjykatë pas administrimit të provave ka vërtetuar se nuk është kontestuese se paditësi nuk është përfitues në kompozimin material për persona të verbërisë në grupin e dytë të cilët persona kanë pjesërisht të dëmtuar të pamurit dhe i takon kompensimi në kuptim të paragrafi 2 të nenit 17 të ligjit.

Kjo gjykatë për të vlerësuar ligjshmërinë aktvendimit kontestues ju referua Ligjit 04/L-092 për persona të verbër respektivisht nenit 17 paragrafi 6 të tij.

Në procedurën sipas ankesës, organi i paditur ka siguruar konstatimin dhe mendimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së dytë dt.16.04.2014, i cili pajtohet me konstatimin dhe mendimin e Komisioneve Mediko-Social të dhëna më parë dhe me vendimin e kontestuar, refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe vërteton vendimin e atakuar.

Prandaj kjo gjykatë duke bërë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të konstatuar pas administrimit të provave në drejtim të perëndimeve të paditësit ka vërtetuar se qëndron arsyetim i të paditurës si në aktin e kontestuar, se i njëjti i plotëson kushtet ligjore në kompensim nga grupi i dytë jo dhe për grupin e parë sepse përfituese drejtës në kompensim për këtë kategorie janë persona të cilët nuk dallojnë dritën nga errësira deri në qartësinë e të pamurit deri 0.02., si e parasheh neni 17 paragrafi 6 i ligjit të lartcekur, për çka këtu paditësi këtu nuk bën pjesë

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit se i plotëson kriteret e ligjit për të drejtën e kompozimit në grupin e parë për persona të verbër por si të tilla këto pretendime kjo gjykate nuk mundi të paranojë sepse i vlerësoj të pabazuara në ligj andaj, i refuzoj.

Nga kjo gjendje e konstatuar si më lart, gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike e zbatuar ligjin material, kur kanë refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar.

Andaj, mbi këto arsye kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoj sepse sipas vlerësimit të saj nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.parg.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1316/2014, dt.14.02.2017,

Sekretare Juridike
Kaltrina Citaku



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.